



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/130


Datë: 16.06.2010

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, dhe paragrafit (3) të nenit 4 Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007 si dhe bazuar në rekomandimet Komisionit Ndërministror të themeluar me qëllim të analizimit të opsioneve për participimin e sektorit privat në PTK, Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh. A. ("PTK"), në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2010, mori

V E N D I M

1. Të ofrohen për tenderim dhe shitje 75 % (shtatëdhjetepesë përqindë) e aksioneve të Ndërmarrjes Publike PTK, Sh. A.
2. Të themelohet Komisioni Qeveritar për Privatizimin e PTK-së në këtë përbërje:
 - Z. Ahmet Shala, Ministër për Ekonomi dhe Financa, Kryesues;
 - Z. Lutfi Zharku, Ministër i Tregtisë dhe Industrisë, anëtar;
 - Z. Fatmir Limaj, Ministër i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, anëtar;
 - Z. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
 - Z. Sadri Ferati, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar.
3. Komisioni Qeveritar për Privatizim të ndjekë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese, në përputhje me kushtet procedurale të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës dhe me standardet më të larta ndërkombëtare.
4. Komisioni Qeveritar për Privatizim të adresoj dhe negocioj në mënyrë të përgjegjshme-sociale kërkesat e arsyeshme të punëtorëve të PTK Sh. A.
5. Komisioni Qeveritar për Privatizim autorizohet të vendosë për detajet e ndarjes së aseteve të postës nga njësitë tjera të biznesit, duke marrë parasysh si duhet:
 - Interesin e Shtetit të Kosovës për të pasur një subjekt postar funksional dhe
 - Maksimumin e çmimit të shitjes së PTK Sh. A.

6. Të sigurohet që njësia e biznesit posta e PTK Sh. A., të shërbej si ofruer universal i shërbimeve postare edhe gjatë procesit të ndarjes ligjore të njësisë së biznesit Posta, e cila ndarje do të bazohet në marrëveshjen paraprake për alokim të aseteve, me apo pa obligimin që të kthehet në pronësinë e Republikës së Kosovës, të vazhdoj.
7. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që këtë vendimin t'ia procedojë për aprovim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë